

SHARRI NË SHËNJESTËR TË KRIMIT



KOSID

KOSOVO CIVIL SOCIETY CONSORTIUM FOR
SUSTAINABLE DEVELOPMENT

KONSORCIUMI KOSOVAR I SHODËRISË CIVILE PËR
ZHVILLIM TË QENDRUESHËM

Dhjetor, 2020

KOSID

KOSOVO CIVIL SOCIETY CONSORTIUM FOR
SUSTAINABLE DEVELOPMENT

KONSORCIUMI KOSOVAR I SHQËRISË CIVILE PËR
ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



SHARRI NË SHËNJESTËR TË KRIMIT

Dhjetor, 2020

Botimi i KOSID - Kosovar Civil Foundation for Sustainable Development. Te gjitha të drejtat janë rezervuar nga KOSID. Ky botim nuk mund të riprodhohet, nuk mund të ruhet në sisteme memorizuese, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, vetëm në tërësi, përdorimi për qëllime komerciale të këtij botimi nuk lejohet pa miratimin me shkrim nga KOSID.

Për informacion info@kosid.eu.com

Publikimi u bë në kuadër të projektit “Zonat e Mbrojtura për Natyrën dhe Njerëzit II”, implementuar nga WWF Adria, me mbështetjen e Agjencisë Suedeze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillim (Sida).

Përparimet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare dhe pozicionin e WWF, Sida, ose të ndonjë organizate tjetër.



PËRMBAJTA

SHKURTESAT	5
Përmbledhje:	6
Hyrja:	6
Qëllimi:	9
Pyetjet:	9
Rezultatet	9
Zjarret:	10
Prerjet ilegale	13
Gjuetia ilegale	17
PËRFUNDIMI	21
A. Aspekti natyror	21
B. Aspekti ligjor	22

SHKURTESAT


DAPK	Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
AMMK	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ZRE	Zonë e Rëndësishme Ekologjike
ZVR	Zonë e Veçantë e Ruajtur
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



SHARRI NË SHËNJESTËR TË KRIMIT

Përmbledhje: Qëllimi i kësaj analize është që të vihen në pah problemet me të cilat ballafaqohet Parku Kombëtar “Sharri”. Si probleme serioze janë: prerja ilegale e drunjve, gjuetia ilegale dhe zjarret. Mungesa e stafit të Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”, krimi i organizuar dhe mosrespektimi i ligjit kanë sjellë deri te degradimi i florës (bimët) në disa pjesë të Parkut të cilat nuk mund të revitalizohen dhe gjithashtu zvogëlim i faunës (shtazët) nëpërmjet gjuetisë ilegale. Kafshë të ndryshme, ekosistemet dhe piramida ekologjike e një habitati është duke shkuar në drejtim të degradimit.

Hyrja: Parku Kombëtar “Sharri” është Parku i parë kombëtar i shpallur në Kosovë në vitin 1986. Funksionimi i Parkut Kombëtar “Sharri” ka filluar në vitin 1995, ndërsa është ndërprerë gjatë periudhës 1999 – 2002, dhe përsëri është riaktivizuar në maj të vitit 2002.¹



Lokacioni i Parkut Kombëtar “Sharri” në Kosovë dhe rajon²

Parku Kombëtar “Sharri” ndodhet në juglindje, jug dhe jugperëndim të Kosovës. Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri” (2012) përkufizon për këtë qëllim një zonë prej 53,469 hektarësh që bie në territorin e pesë komunave: Kaçanik (4.1 %), Shtërpçë (23.9%), Suharekë (4.7%), Prizren (22.2%) dhe Dragash (45.1%).³

1. Shih: <http://ammk-rks.net/?page=1,123>

2. Shih: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Plani_i_menaxhimit_i_PK_Sharri_2015-2024.pdf


3. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Plani_i_menaxhimit_i_PK_Sharri_2015-2024.pdf, faqe 14.



Mbrojtja e Parkut Kombëtar “Sharri”, natyrës dhe mjedisit është e siguruar me Ligjin Nr. 04/L – 087 për Parkun Kombëtar “Sharri”⁴, Ligjin Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës⁵ si dhe Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit⁶. Poashtu, menaxhimi i Parkut Kombëtar “Shari” rregullohet edhe përmes Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri” dhe Planit Menaxhues i Parkut Kombëtar “Sharri”⁷

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Park Kombëtar është territori natyror me funksionet në:

- a) mbrojtjen e tërësisë ekologjike, të një apo më shumë ekosistemeve, për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
- b) përjashtimin e shfrytëzimeve apo uzurpimet me qëllim të ndryshimit dhe dëmtimit të natyrës;
- c) sigurimin e bazave për qëllime shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative, kulturore dhe mundësi vizitash, në pajtim me parimet e mbrojtjes së mjedisit.⁸



Zonat funksionale të Parkut Kombëtar „Sharri”⁹

4. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2866>

5. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716>

6. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631>

7. Shih: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/PHPK_Sharri_shq.pdf

8. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Plani_i_menaxhimit_i_PK_Sharri_2015-2024.pdf

9. Shih: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Plani_i_menaxhimit_i_PK_Sharri_2015-2024.pdf



Neni 3 i Ligjit për Parkun Kombëtar “Sharri” specifikon kushtet për zonat vijuese funksionale të Parkut.¹⁰ Sipas planit hapësinor, Parku Kombëtar “Sharri” ndahet në tri Zona, si vijon:

- 1. Zona e mbrojtjes strikte (Zona e parë mbrojtëse):** Përfshin pjesë të territorit të Parkut Kombëtar “Sharri” me karakteristika të jashtëzakonshme natyrore, me specie të rralla, bimë dhe kafshë të rrezikuara dhe llojet të habitateve në kushte të egra të natyrës.¹¹
- 2. Zona e menaxhimit aktiv (Zona e dytë mbrojtëse):** Përfshin pjesë të territorit të Parkut Kombëtar “Sharri” që karakterizohen nga ekosistemet, vlera të peizazhit dhe vlera të tjera ku mund të ushtrohet ekoturizmi, bujqësia tradicionale dhe aktivitete që nuk janë në mospërputhje me qëllimet e mbrojtjes.¹²
- 3. Zona e shfrytëzimi të qëndrueshëm (Zona e tretë mbrojtëse):** Përfshin pjesë të territorit të Parkut Kombëtar “Sharri” të caktuar për: ndërtim, rindërtim, mbrojtje të objekteve tradicionale dhe rekreative, turizëm dhe nevojat e banorëve në territorin e Parkut Kombëtar “Sharri”, si dhe shfrytëzim të kullosave dhe shfrytëzim ekonomik të të mirave të natyrës sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, si dhe në harmoni me ligjet përkatëse dhe Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar.¹³

Gjithashtu ekziston edhe një zonë e cila quhet **Zona e Ndikimit**: Një zonë prej pesëdhjetë (50) metrash nga kufiri i Parkut Kombëtar “Sharri” që shërben për të parandaluar ndikimet negative në këtë park. Në zonën e ndikimit zbatohet regjimi i mbrojtjes si në zonën e dytë të mbrojtjes.¹⁴

Ligje të tjera mbështetëse për menaxhimin dhe mbrojtjen e Parkut Kombëtar “Sharri” janë Ligji Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës¹⁵, Ligji Nr. 2004/29 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës,¹⁶ si dhe Ligji Nr. 03/L-153 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës¹⁷.

Vizioni i përgjithshëm i Parkut Kombëtar “Sharri” është:

- Një Park i menaxhuar me kujdes për brezat e ardhshëm, një Park me larmi biologjike, peizazhe të veçanta, banesa tradicionale dhe vendbanime që vlerësohen, mbrohen dhe zhvillohen;
- Një park në të cilin përfitimet ekonomike u shërbejnë interesave të mbrojtjes së mjedisit dhe bashkësive lokale.
- Një park i arritshëm, i cili u ofron vizitorëve mundësi argëtimi me aktivitete rekreative, sportive, kulturore dhe kërkimin shkencor.¹⁸

Vlerat natyrore të Parkut Kombëtar “Sharri” përfshijnë një sërë ekosistemesh në gjendje të mirë në vende të ndryshme, nga malet e larta deri në kodra. Ato shoqërohen me një florë dhe faunë pothuajse të paprekur të përbërë nga shumë specie të rralla dhe endemike.¹⁹

10. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2866>

11. Shih: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Plani_i_menaxhimit_i_PK_Sharri_2015-2024.pdf, faqe 9

12. Shih: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Plani_i_menaxhimit_i_PK_Sharri_2015-2024.pdf, faqe 9

13. Shih: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Plani_i_menaxhimit_i_PK_Sharri_2015-2024.pdf, faqe 9

14. Shih: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Plani_i_menaxhimit_i_PK_Sharri_2015-2024.pdf, faqe 9

15. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2566>

16. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2566>

17. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2668>

18. Shih: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Plani_i_menaxhimit_i_PK_Sharri_2015-2024.pdf

19. Shih: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Plani_i_menaxhimit_i_PK_Sharri_2015-2024.pdf



Zonat pyjore mbulojnë rreth 34% të të gjithë zonës së Parkut Kombëtar “Sharri”. Faktorët më sfidues që ndikojnë në sektorin pyjor në Kosovë kanë të bëjnë me menaxhimin e dobët, prerjen e paligjshme të pyjeve, degradimin e tokave pyjore si rezultat i prerjeve të paligjshme, nxjerrjes së pakontrolluar të zhavorrit, ndikimi i kafshëve ose insekteve të dëmshme si p.sh insekti dëmtues i pishës (*Thaumtopoea pityocampa*), sëmundjeve dhe zjarreve.

Një nga sfidat është menaxhimi joadekuat ekonomik i zonave të menaxhimit të pyjeve Koritnik në Dragash, Kaçanik dhe Shtërpçë. Prerja ilegale është e përhapur për shkak se ky dru përdoret për djegie. Mbi 500 procese gjyqësore janë ngritur kundër prerësve të paligjshëm gjatë 10 viteve të fundit.²⁰

Sfida tjetër është gjithashtu gjuetia e paligjshme. “Gjuetia e paligjshme dhe e pakontrolluar rrezikon të gjitha speciet, veçanërisht ato të rralla, kafshët e egra që janë më të rrezikuara në zonën tonë janë Ariu dhe Drenusha pasi ato janë të rrezikuara, si rezultat i gjuetisë së paligjshme dhe të pakontrolluar”, tha Sadri Hodaj, nga Shoqata e Gjahtarëve “Sharri” nga Prizreni. Sipas tij, kjo situatë mund të rregullohet vetëm duke respektuar dispozitat ligjore.²¹ “Gjuetia është e ndaluar në Parkun Kombëtar “Sharri”, por vazhdon në Dragash përmes klubeve të gjuetisë.²²

Qëllimi: Kjo analizë synon të identifikojë problemet dhe parregullsitë në Parkun Kombëtar “Sharri” që kanë ndikuar në degradimin e florës dhe faunës, ndikimi në biodiversitetin e këtij vendi dhe ndikimin që ka pasur faktori njeri në ekosistemin përreth Parkut Kombëtar “Sharri”.

Kërcënimet kryesore për vlerat e Parkut Kombëtar “Sharri”:

- a) Gjuetia e ilegale
- b) Zjarret
- c) Degradimi i pyjeve përmes shpyllëzimeve

Pyetjet: Kjo analizë ka përfshirë këto pyetje:

- 1) Sa është e pranishme prerja e pyjeve në Parkun Kombëtar “Sharri”?
- 2) Sa është e pranishme gjuetia e paligjshme në Parkun Kombëtar “Sharri”?
- 3) Sa janë të pranishme dhe të shpeshta zjarret në Parkun Kombëtar “Sharri” dhe cilat janë shkaqet?

Rezultatet: Analiza e Parkut Kombëtar “Sharri” e punuar nga KOSID është e ndarë në tri pjesë: prerja e pyjeve, zjarret dhe gjuetia ilegale. Pas hulumtimeve, intervistave, shqyrtimit të raporteve të ndryshme, KOSID ka ardhur me këto rezultate.

20. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Plani_i_menaxhimit_i_PK_Sharri_2015-2024.pdf

21. Shih: <https://kallxo.com/gjate/hulumtim/gjuetia-ilegale-po-rrezikon-faunen-e-kosoves/>

22. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf



◆ Zjarret:

Më të rrezikuara janë pyjet e rrobullit (*Pinetum heldreichii*) të cilët kanë pësuar dëmtime të konsiderueshme nga zjarret pyjore (2000, 2007 dhe 2012).²³ Kështu pyjet e rrobullit që shtrihen në pjesën e Oshllakut, Koxhaballkan dhe Pashallare me sipërfaqe prej 10 %, janë të dëmtuara si pasojë e zjarrit pyjor të vitit 2000 dhe zhvillimit intenziv të insekteve dëmtuese që janë shfaqur në mënyrë masive pas djegies (*Ips. sp. dhe Blatophagus sp.*). Në kuadër të saj, prej 10% sipërfaqes të cilën e mbulojnë, tërësisht të dëmtuara janë 4.5 %.²⁴



*Bashkësia pyjore e rrobullit (Pinetum heldreichii)*²⁵

Gjatë vitit 2012 në regionin e Prizrenit, në Malin Koretnik, ka pasur vatra të zjarreve me intensitet të ulët ku janë përfshirë 1.5 hektar të parkut i cili është vënë nën kontroll dhe shuar nga zyrtarët e Pylltarisë. Dukuria e shfaqjes së zjarreve ka ardhur duke u intensifikuar sidomos gjatë muajit gusht, saktësisht më 22.08.2012, i cili është lokalizuar dhe vënë nën kontroll më 28.08.2012 ku janë përfshirë sipërfaqe më të mëdha por edhe më kualitative të pyjeve me kulturë halore.²⁶ Sipas Bajram Kafexhollit, drejtor i Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” “Zjarri i vitit 2012 ka qenë i qëllimshëm, sepse pikërisht atë vit, në 2012 është bërë zgjerimi i Parkut Kombëtar “Sharri” ku ky zjarr mendohet të ketë qenë i qëllimshëm për shkak se industria e drurit ka llogaritur që këtë pjesë ku zgjerohej parku, në pjesën me dru të Koretnik-it, ata synonin ta marrin për dru teknik (dru i cili përdoret për ndërtimtari). Kur parku është zgjeruar, kjo ka ndaluar përdorimin legal të pyllit për prerje për industri dhe si rezultat zjarri është futur në shenjë proteste.”²⁷

23. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf

24. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf

25. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf

26. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf

27. Intervistë me Drejtorin e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” Bajram Kafexholli me datën 06.10.2020



Zjarri në Parkun Kombëtar “Sharri” mes datës 22.08.2020-28.08.2020 dhe pasojat e tij²⁸

Në raportin mjedisor të viteve 2015-2017 shohim që gjendja e vështirë në veçanti paraqitet në pyjet e rrobullit (*Pinetum heldreichii*) në zonat e Koritnikut dhe Pishës së Madhe si pasojë e zjarreve të viteve 2000, 2007, 2012 dhe 2015 dhe zhvillimit të insekteve dëmtuese (nënivorësve)- Scolitide.

Nga djegiet masive të pyjeve dhe zhvillimit intensiv të insekteve dëmtuese (nënivorësve) janë tharë rreth 1000 hektarë pyje në malin Koretnik dhe rreth 100 hektarë pyje të rrobullit në zonën e Pishës së Madhe.²⁹ Djegiet më së shumti janë si shkaqe e hedhjes së cigareve, piknikeve të ndryshme ku individët e ndryshëm dalin dhe ndezin zjarr për ushqim etj. Gjatë dy viteve të fundit (2018-2020), pjesa e cila ishte djegur në vitin 2012 ka filluar të pastrohet nga dëmtimet duke filluar me largimin e drunjve të djegur.³⁰



Dëmet pyjore nga zjarret në pyjet e rrobullit në Koritnik³¹

28. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf

29. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_per_gjendjen_e_natyres_2015-2017.pdf

30. Intervistë me Drejtorin për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” Bajram Kafexholli me datën 06.10.2020

31. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf



Me kalimin e viteve shohim që zjarret janë më shumë të pranishme në zonat e kullosave me sipërfaqe barishtore. Këto zona duket të jenë më lehtë të ndezshme.

Zjarret në Parkun Kombëtar “Sharri gjatë periudhës 2017-2020

- Viti 2017:** kanë qenë 6 zjarre në zonat malore Kortinik, Bjeshka e Kabashit, Oshlak, Konjushkë, Kobolicë dhe Vërtop. Dëmet kanë qenë kryesisht në vegjetacionin barishtor në sipërfaqe rreth 3 hektarë.
- Viti 2018:** kanë qenë 5 zjarre në zonat malore Bjeshka e Dellocit, Kobilicë, Konjushkë, Koxha Ballkan, dhe Gotovushë. Janë dëmtuar kryesisht vegjetacionet barishtore në sipërfaqe prej rreth 2 hektarë.
- Viti 2019:** kanë qenë 8 zjarre më të theksuara; 5 zjarre në zonat malore të Brodit dhe Firajës (komuna e Shtërpçës) dhe 3 zjarre në rajonet e fshatrave Brod, Restelicë dhe Krushevë (komuna e Dragashit). Janë dëmtuar kryesisht sipërfaqet barishtore (kullosat) në sipërfaqe rreth 100 hektarë.
- Viti 2020:** nuk ka pasur zjarre të theksuara. Arsyeja më e madhe është që pandemia/situata me COVID-19 ka bërë që të zvogëlohet numri i zjarreve. Veçohet zjarri në rajonin e fshatit Manasterica ku janë djegur sipërfaqet barishtore dhe shkurre prej 2 hektarë.³²

32. Të dhënat të dërguara nga Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”



◆ Prerjet ilegale

Në raportin për gjendjen e natyrës të viteve 2010-2014 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor tregohet mirë që gjendja e resurseve natyrore në Parkun Kombëtar “Sharri” është e paqëndrueshme si pasojë e ndikimeve negative të faktorëve biotikë (njeriu, insektet, sëmundjet) dhe abiotikë (zjarret, fatkeqësitë natyrore: era, bora etj.).³³ Gjithashtu nëse flasim për faktorë abiotikë, ndikimi i tyre mund të jetë evident si p.sh. zvogëlimi i reshjeve të shiut, temperaturat e larta etj, por si faktor i cili ka ndikim të keq është faktori antropogjen apo ndryshe faktori njeri. Më i rrezikuari është vegjetacioni pyjor i cili mbulon afro 35% (18,298 hektarë) të sipërfaqes së Parkut Kombëtar “Sharri”. Pyjet e ahut kanë përhapje më të madhe në Parkun Kombëtar “Sharri” me llojet *Fagetum montanum* dhe *Fagetum subalpinum*.³⁴ Kjo e bën që ky lloj i drurit të jetë i rrezikuar nga prerjet ilegale në këtë park. Kjo dukuri negative, në veçanti, është e pranishme në rajonet e fshatrave Delloc dhe Maçitevë të komunës së Suharekës, Manastircë dhe Koritniku 1 të Komunës së Prizrenit dhe në rajonet e ndryshme të komunës së Shtërpçës që kanë mbetur jashtë qeverisjes së MMPH-së (DAPK-së).³⁵



Prerjet ilegale të pyjeve në Parkun Kombëtar “Sharri”³⁶

33. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf

34. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf

35. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf

36. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf



Kurse në raportin e viteve 2015-2017 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor³⁷ shohim përhapje të këtij aktiviteti edhe në disa komuna të tjera. Dëmet pyjore nga prerjet ilegale kanë qenë më të theksuara në rajonet e Brodit dhe Firajës të komunës së Shtërpçës si dhe në rajonin Jasikës të Lubotenit në komunën e Kaçanikut. Aktiviteti i prerjes ilegale në komunat Kaçanik dhe Shtërpçë ishte edhe i mëhershëm. Raporti i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të viteve 2011-2012 për gjendjen e natyrës thotë se dëme të konsiderueshme të pyjeve të ahut ka pasur në territorin e Parkut Kombëtar që gjendet në komunat e Shtërpçës dhe Kaçanikut.³⁸ Kjo është si pasojë e mungesës së kompetencave menaxhuese të Drejtorisë së Parkut Kombëtar “Sharri” (MMPH-së) në këto dy komuna që menaxhoheshin nga institucionet paralele serbe në Shtërpçë.³⁹ Kurse në vitin 2013, institucionet paralele serbe janë larguar dhe nga ai vit pjesa e Parkut Kombëtar “Sharri” në Shtërpçë menaxhohet nga institucionet e Republikës së Kosovës.⁴⁰ Rajonet të cilat kanë më së shumti probleme me prerjet ilegale janë: Rajoni i Jasikës së komunës së Kaçanikut, pjesa e Shtërpçës me pjesët Brod dhe Firajë. Gjatë viteve 2016-2020 në Gjykatën Themelore të Prizrenit dhe të Ferizajt janë paraqitur një numër i madh i fletëpadive për prerje dhe vjedhje pylli në zonën e mbrojtur të Parkut Kombëtar “Sharri”. Këto fletëpadi janë dorëzuar nga Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” me zyrtarët ligjorë të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Paditë dorëzohen duke pasur parasysh se në cilën komunë janë kapur prerësit ilegale të drurit.

- Gjatë viteve **2016-2017** janë shkaktuar dëmet pyjore nga prerjet ilegale në sasi prej **12,014.12 m³**, kryesisht në komunat e Kaçanikut dhe Shtërpçës ku Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” nuk ka pasur të punësuar rojtarë të natyrës. Në gjykatat themelore të Prizrenit dhe Ferizajt në vitin 2017 janë dorëzuar **111 fletëpadi penale** për sasinë drunore prej **297.12 m³**.

- Në vitin **2018** në Parkun Kombëtar “Sharri” janë regjistruar dëmet pyjore nga prerjet ilegale në sasi prej **4436.03 m³**, të cilët kanë qenë më të theksuara në rajonet e Brodit dhe Firajës të komunës së Shtërpçës si dhe në rajonin e Jasikës së Kaçanikut. Në gjykatat themelore të Prizrenit dhe Ferizajt janë dorëzuar **188 padi** për vjedhje pylli në zonën e mbrojtur të Parkut Kombëtar “Sharri” për sasinë drunore prej **643.85 m³**.

- Në vitin **2019** në Parkun Kombëtar “Sharri” janë regjistruar dëmet pyjore nga prerjet ilegale në sasi prej rreth **2,500.00 m³**. Prerjet ilegale të pyjeve kanë qenë më të theksuara në rajonet e Brodit dhe Firajës të komunës së Shtërpçës si dhe në rajonin e Jasikës të komunës së Kaçanikut. Në krahasim me vitet e kaluara, **162** padi për vjedhje pylli në zonën e mbrojtur të Parkut Kombëtar “Sharri” për sasinë drunore prej **347.02 m³**.

- Në vitin 2020 deri më tani janë regjistruar mbi **1000 m³** dëme të masës drunore. Raporti përfundimtar për dëmet pyjore planifikohet të përpilohet në fund të muajit nëntor.⁴¹

KOSID ka biseduar me disa zyrtarë që merren me mbrojtjen e pyjeve dhe ata janë bindur që në pjesën e Kaçanikut operon krim të organizuar sa i përket prerjes së drunjve. Një grup i personave përcjellin rojtarët, përcjellin policinë dhe këtë e bëjnë duke punësuar individë të tjerë. Identiteti dhe emrat e tyre janë të paraqitura në rajonin policor të Kaçanikut ku kanë me dhjetra fletëparaqitje në gjykatë.⁴²

37. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_per_gjendjen_e_natyres_2015-2017.pdf

38. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_Gjendja_e_Mjedisit_Web_Shqip.pdf

39. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_Gjendja_e_Mjedisit_Web_Shqip.pdf

40. Intervistë me Drejtorin e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”, Bajram Kafexholli me datën 06.10.2020

41. Të dhënat të dërguara nga Drejtoria për Administrimin e parkut kombëtar “Sharri”

42. Intervistë me punonjës nga Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” me datën 06.10.2020



Procesi është i tillë që nëse dikush kapet me dru nga prerja ilegale, atij/asaj menjëherë i konfiskohet automjeti dhe sasia e druve të prerë.



Drurët e konfiskuar të cilët gjenden në oborrin e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” që disa vite⁴³



Automjetet e konfiskuar të cilat gjenden në oborrin e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” që disa vite⁴⁴

Në atë moment, Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” e bën një fletëparaqitje dhe ajo dërgohet në AMMK. Zyrtarja nga ky agjension bën kallëzim penal në gjykatë dhe pastaj gjykata merret me rastin. “Shumica dënohen, por nëse ka njoftësi atëherë mund edhe të mos dënohen”⁴⁵. Shkaku kryesor i prerjeve ilegale të pyjeve është gjendja e vështirë socio-ekonomike e popullatës rurale e cila drurin e ahut e përdor si burim kryesor për ngrohje dhe mosrealizimi i fletëpadive të Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” në gjykatat përkatëse.⁴⁶

43. Fotografi të bëra nga oborri i Drejtorisë së Administrimit të Parkut Kombëtar “Sharri”

44. Fotografi të bëra nga oborri i Drejtorisë së Administrimit të Parkut Kombëtar “Sharri”

45. Intervistë me Drejtorin e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”, Bajram Kafexholli me 06.10.2020

46. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf, faqe 47.



Drurët e konfiskuar të cilët gjenden në oborrin Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” me vendim të kryeshefit të Agjencionit për Mbrojtjen Mjedisit të Kosovës u dhurohen familjeve në nevojë (kushte të rënda sociale), kurse sa i përket automjeteve të konfiskuara pronarët e automjeteve duhet të marrin leje nga gjykata që t’i tërheqin ato.

Prerjet në Parkun Kombëtar “Sharri” janë të ndaluara me ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. “Dëmtimi i natyrës nga prerjet ilegale është shumë i dëmshëm sepse atëherë Parku Kombëtar “Sharri” e humb vlerën si rezervat i natyrës dhe kjo zonë pastaj e humb epitetin zonë e mbrojtur dhe mund të përdoret për nevoja të ndryshme”⁴⁷ Por prerjet lejohen vetëm me pastrime sanitare. Masa drunore nga pastrimet sanitare është dedikuar për plotësimin e nevojave për dru djegës të komunitetit lokal. Kjo ka ndikuar në zbutjen e kërkesave të mëdha për dru djegës në zonat rurale të Parkut Kombëtar “Sharri”, parandalimin e prerjeve ilegale dhe krijimin e marrëdhënieve miqësore të Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” me komunitetin lokal që paraqesin grupin e interesit me rëndësi të veçantë për Parkun Kombëtar “Sharri”. Pastrimet sanitare bëhen në pyje kur drurët janë të sëmurë, të kalbur, të shtrembëruar apo të cilat e zënë rrugën, drurët e thatë etj. Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” u lëshon leje për pastrim sanitar familjeve të zonave të cilat janë në Parkun Kombëtar “Sharri”. Një familje gjatë pastrimeve sanitare është e lejuar të pajiset me 12 metra kub dru. Dobitë e pastrimeve sanitare janë të gjithanshme në aspektin ekologjik, social dhe ekonomik.⁴⁸

Pastrimi sanitar i pyjeve gjatë periudhës 2017-2020

- Në vitin 2017 janë realizuar pastrimet sanitare të masës së dëmtuar dhe infektuar drunore në sasi prej 4,444.89 m³, shumica dru të ahut (pyjet publike - 2,998.09 m³ dhe pyjet private- 1,444.80 m³). Nga shitja e masës drunore nga pastrimet sanitare janë realizuar mjetet financiare në vlerë prej 47,371.78 € (në pyjet publike 45,201.59 € dhe në pyjet private 2,170.20 €).

- Në vitin 2018 janë realizuar pastrimet sanitare të masës së dëmtuar dhe infektuar drunore në sasi prej 5,638.53 m³, shumica dru të ahut (pyjet publike 4,608.43 m³ dhe pyjet private – 1,030.10 m³). Nga shitja e masës drunore nga pastrimet sanitare janë realizuar mjetet financiare në vlerë prej 58,110.19 € (në pyjet publike 56,565.04 € dhe në pyjet private 1545.15 €).

- Në vitin 2019 janë realizuar pastrimet sanitare të masës së dëmtuar dhe infektuar drunore në sasi prej 6,688.10 m³, shumica dru të ahut (pyjet publike 5,024.04 m³, pyjet private 1,688.10 m³). Masa drunore nga pastrimet sanitare është dedikuar për plotësimin e nevojave për dru djegës të komunitetit lokal. Nga shitja e masës drunore nga pastrimet sanitare janë realizuar mjetet financiare në vlerë prej 59,181.54 € (në pyjet publike 56,685.45 €; në pyjet private 2,496.09 €).

- Në vitin 2020 pastrimet sanitare kanë filluar në mesin e muajit gusht dhe sipas planit duhet të përfundojnë më 15.11.2020. Për këtë vit planifikohet që pastrimi sanitar i masës drunore të jetë i përafërt me masën drunore të vitit 2019.

Masa drunore nga pastrimet sanitare është dedikuar për plotësimin e nevojave për dru djegës të komunitetit lokal.⁴⁹

47. Intervistë me Behxhet Mustafën, profesor në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore të Universitetit të Prishtinës, departamenti i Ekologjisë

48. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_per_gjendjen_e_natyres_2015-2017.pdf

49. Të dhënat të dërguara nga Drejtoria për Administrimin e parkut kombëtar “Sharri”



◆ Gjuetia ilegale

Fauna në Parkun Kombëtar “Sharri” është shumë e larmishme me lloje të ndryshme të gjallesave dhe me specie të rrezikuara në nivel evropian. Në këtë grup përfshihen gjitarët e mëdhenj si ariu i murrmë, ujku, macja e egër dhe çakalli i artë. Speciet të cilat përbëjnë gjah parësor të mishngrënësve më të mëdhenj janë po ashtu me rëndësi, në veçanti dreri i cili është specia e preferuar për gjah nga gjahtarët dhe gjahtarët ilegalë. Kjo vlerë shtohet për shkak të pranisë së ekosistemeve të ngjashme dhe popullatave të ndërlidhura me shtetet fqinje – Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut⁵⁰. Në raportin e vitit 2010-2014 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për gjendjen e natyrës thuhet se nga gjuetia ilegale më të rrezikuar janë kaprojtë (drerët) dhe dhitë e egra, ndërsa zhvillim të mirë kanë ariu i murrmë dhe ujku.⁵¹



Ariu i murrmë dhe dhia e egër në PK “Sharri”⁵²

Këto lloje vazhdojnë të jenë të rrezikuara edhe në vitet në vijim dhe këtë e mbështesin edhe raportet për gjendjen e natyrës të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të viteve në vazhdim 2015-2017 ku thuhet: “Gjendja e faunës është relativisht e mirë, por rrezik të përhershëm për disa lloje të kafshëve (kaprojtë dhe dhitë e egra) paraqet gjuetia ilegale e cila shfaqet kohë pas kohe (posaçërisht vikendit) në disa zona të Parkut Kombëtar “Sharri”, siç janë: Shutmani, Oshlaku, Bistra, Koxha Ballkani, Rusenica dhe Liqeni i Jazhincës”.⁵³ Destinimi i kafshëve të vrara nga gjuetia ilegale janë restorantet në zonën e Zhupës dhe më gjerë, andaj për ndalimin e shitjes së mishit të ndaluar duhet më seriozisht të kyçet inspektorati përkatës komunal dhe qendror.”⁵⁴ Rreziku për gjueti ilegale nuk vjen vetëm nga banorët e Republikës së Kosovës por ka raste kur banorët e shteteve si Maqedonia e Veriut apo Shqipëria kalojnë në territorin e Kosovës me pretekstin se bagëtitë futën në kullosat e teritorit të Parkut Kombëtar “Sharri” në Kosovë dhe në mënyrë ilegale ushtrojnë gjuetinë në faunën e këtij parku.⁵⁵ Kjo është e jashtëligjshme për arsye se 500 metra jashtë kufirit të Republikës së Kosovës nuk lejohen aktivitetet të cilat e degradojnë florën dhe faunën e “Sharri”-it.

50. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_per_gjendjen_e_natyres_2015-2017.pdf

51. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf

52. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_per_gjendjen_e_natyres_2015-2017.pdf

53. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_per_gjendjen_e_natyres_2015-2017.pdf, faqe 55

54. Shih: https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_per_gjendjen_e_natyres_2015-2017.pdf

55. Intervistë me Drejtorin e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”, me datën 06.10.2020



Kaprolli, specie e rrezikuar sipas Lbrit të Kuq të Faunës⁵⁶

“Kurse gjatë periudhës 2017-2020, kohë pas kohe paraqitet gjuetia ilegale në disa zona malore siç janë: Koritniku, Shutmani, Oshlaku, Koxha Ballkani, Liqeni i Jazhincës, Konjushka etj. Problem të veçantë në komunën e Dragashit paraqesin gjahtarët ilegalë nga Shqipëria të cilët veprojnë në zonën kufitare nga Koritniku deri të Rudoka. Gjithashtu, kohë pas kohe paraqiten ndërhyrjet ilegale të gjahtarëve nga Maqedonia e Veriut në zonat malore të Konjushkës dhe Dupnicës. Kafshët më të rrezikuara nga gjuetia ilegale janë dhitë e egra dhe kaprojtë. Gjatë viteve 2018-2020 kemi një zvogëlim të gjuetisë ilegale.”⁵⁷ Sipas Drejtorisë për Administrim të Parkut Kombëtar “Sharri”, banorët e anëve të ndryshme të Parkut Kombëtar “Sharri” janë më të vetëdijësuar dhe po i lajmërojnë të shtënat e armëve që i dëgjojnë në polici me ç’rast njoftohet edhe Drejtoria.

Gjuetia është e ndaluar në hapësirën e Parkut Kombëtar “Sharri”, gjahtarët janë të lejuar të bëjnë gjah vetëm gjatë sezonës së gjuetisë e cila hapet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. “Sipas Ministrisë, hapjen dhe kohëzgjatjen e sezonit të gjuetisë sipas Ligjit, mund ta bëjë vetëm Ministri i Bujqësisë me vendim dhe assesi ndonjë organ apo institucion tjetër.”⁵⁸ Që të hapët sezona e gjuetisë varet nga kalendari i MBPZhR dhe nga informacionet e terrenit, si një nga pikat kryesore është që gjuetia nuk lejohet të ushtrohet në kohën e çiftëzimit të kafshëve apo kur ato janë me barrë. Lejen për gjueti e marrin shoqatat e gjahtarëve, ku secila shoqatë e ka vendgjuetinë e tyre ku u lejohet gjuetia. Këto vendgjueti janë jashtë teritorit të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Njëra prej shoqatave më të vjetra në Prizren është Shoqata e Gjahtarëve “Sharri”. Sedat Krasniqi, sekretar i shoqatës, ka thënë: “Ne si shoqatë kemi persona të cilët janë në teren dmth në terrenin e Prizrenit dhe e monitorojnë gjendjen e asaj ane sa i përket gjuetisë ilegale. Numri i rojtarëve është 52. Kjo shoqatë

56. Shih: [https://ammk-rks.net/repository/docs/v2Libri_i_Kuq_-_6shtator_1_\(1\).pdf](https://ammk-rks.net/repository/docs/v2Libri_i_Kuq_-_6shtator_1_(1).pdf), faqe 82.

57. Intervistë me Drejtorin e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”, me datën 06.10.2020

58. Shih: <https://www.koha.net/arberi/242935/gjuetia-ilegale-rrezikon-zhdukjen-e-shume-kafsheve/>



gjithashtu ka të vendosura edhe kamera kurth për monitorimin e shtazëve të asaj ane. Rojtarët të cilët janë në teren bashkëpunojnë ngusht me rojtarët e Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”.⁵⁹

Gjuetia ilegale e cila realizohet në Parkun Kombëtar “Sharri” ka pasoja të ndryshme. Realisht, gjuetia në Parkun Kombëtar “Sharri” dëmton habitatet e shtazëve të egra, pasi që shtazët tmerohen nga të shtënat e armëve të gjahtarëve që dalin për gjueti në atë anë. Shumë gjahtarë i shfrytëzojnë lejet për gjueti të cilën e marrin nëse anëtarësohen në ndonjë shoqatë për gjueti për të marrë armën për gjueti me leje dhe pastaj e përdorin atë në mënyra të ndryshme për gjueti në zona të cilat nuk mund të bëhet gjuetia si Parku Kombëtar “Sharri”⁶⁰, Në vitin 2020, sezoni i gjuetisë është hapur më 1 nëntor. Në vitin e kaluar, me të drejtë, sezoni i i gjuetisë ishte mbyllur me vendim të ministrit Besian Mustafa, me arsyetimin se ka zvogëlim të numrit të kafshëve të egra.⁶¹

Gjuetia ushtrohet në dy mënyra, atë me pushkë dhe atë me qen për gjueti. Këto dy forma të gjuetisë janë po aq të dëmshme sa njëra-tjetra. Në rastin e gjuetisë me armë, gjahtari i ka 3 fishekë dhe me ata duhet të bëjë gjueti, kurse në rastin e gjuetisë me qen, gjahtari i lëshon qentë që të afrojnë prenjë afër gjahtarit dhe pastaj e bën më të lehtë për nxënie të presë. Gjithashtu ka raste ku zyrtarë nga institucionet e larta të Kosovës në vikende ushtrojnë gjuetinë ilegale po në këtë park. Zonat ku këta zyrtarë bëjnë gjueti janë pjesët e Suharekës dhe Prizrenit.⁶²

Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” vepron me këtë staf:

Dy shefa të sektorëve, stafi për teren, stafi administrativë dhe profesional. Këtu janë 18 zyrtarë. Çdo vit pranohen nga 10-12 rojtarë me kontratë mbi vepër të cilët kontrahohen për periudhën 6 mujore. Kjo për shkak të buxhetit jo të mjaftueshëm i cili i ndahet kësaj drejtorie që pamundëson që të pranohen rojtarë për periudha më afatgjata. Plani menaxhues i Parkut Kombëtar “Sharri” parasheh që stafi i Drejtorisë për Administrimin “Sharri” të jetë me një numër prej 50 punonjësve, kurse tani janë 28-30 veta. Një prej sfidave me të cilat ballafaqohet Parku Kombëtar “Sharri” është edhe mungesa një zyrtari për faunë. I kaluari ka dalë në pension dhe institucionet përkatëse pretendojnë që përshkak të pandemisë me virusin COVID-19, nuk është hapur konkursi për një zyrtar të ri për faunë. Kjo ndikon në gjuetinë ilegale, sepse nuk ka kush të merret me këtë problem drejtpërdrejt.

Pas skadimit të kontratës mbi vepër të rojtarëve, hapet konkursi i cili vazhdon për 2 muaj. Aplikuesit para se të pranohen kalojnë dy teste, një me gojë dhe tjetri me shkrim. Arritja e një numri të kënaqshëm të aplikuesve është një sfidë e madhe, sidomos në pjesën e Kaçanikut dhe të Shtërpçës ku ka raste që duhet t’i lusin banorët që të aplikojnë. Arsyet e mosinteresimit mund të jenë të ndryshme si ndenja e pasigurisë në teren, problemet me ushtruesit e veprave kriminale etj. Në pjesën e Prizrenit janë rojtarë me kontrata të rregullta sepse ajo pjesë ka qenë pjesë e Parkut Kombëtar “Sharri” prej vitit 1986, kurse rojtarët e pjesëve të tjera janë me kontrata mbi vepër. Probleme ka pasur në pjesën e Dragashit ku strukturat paralele të Serbisë nuk kanë pranuar të hyjnë në menaxhim të parkut në vitin 2007/08 kur është bërë zgjerimi i parkut. Në vitin 2013, këto struktura paralele janë larguar dhe prej atë viti, pjesën e Dragashit e menaxhon Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”. Zonat e Kaçanikut, Shtërpçës dhe Dragashit janë të pambuluara me rojtarë. Këto zona mbulohen vetëm me rojtarë të cilët kanë kontrata mbi vepër, sepse mungesa e buxhetit nuk e lejon që të punësohen rojtarë me kontrata njëvjeçare ose më shumë. Gjithashtu shpërndarja e rojtarëve bëhet duke u varur nga madhësia e terrenit, sepse p.sh, zona e Prizrenit ka territor më të madh atëherë duhet edhe një numër më i madh i rojtarëve

59. Intervistë me Sedat Krasniqin nga Shoqata e Gjahtarëve “Sharri” Prizren me datën 16.11.2020

60. Intervistë me Fatos Lajqin nga ERA NGO me datën 07.11.2020

61. Shih: <https://www.koha.net/arberi/242935/gjuetia-ilegale-rrezikon-zhdukjen-e-shume-kafsheve/>

62. Intervistë me punonjës të Drejtorisë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”



SHARRI NË SHËNJESTËR TË KRIMIT

në atë pjesë. Në zonat e Prizrenit, Suharekës, Shtërpcës dhe Kaçanikut janë zona pyjore, kurse zona e Dragashit është zonë e kullosave. Pjesët Kaçanik, Shtërpcë, Dragash, Suharekë kanë nga 2 rojtarë kurse Prizreni ka 6 rojtarë. Kjo bën që 60-70 % e teritorit të jetë e pambuluar me rojtarë.



PËRFUNDIMI

A. Aspekti natyror

- **Prerjet ilegale:** Sipas gjetjeve dhe intervistave rezulton që një prej problemeve me të cilat ballafaqohet Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” është buxheti i vogël që i destinohet këtij institucioni. Kjo rezulton në zvogëlimin e numrit të rojtarëve me kontrata të rregullta por edhe në mungesë të stafit që duhet të jenë brenda normave të cilat janë caktuar me Planin për Menaxhimin e Parkut Kombëtar “Sharri”. Problem serioz janë edhe grupet e krimit të organizuar të cilat merren me prerje ilegale të pyjeve në Parkun Kombëtar “Sharri”. Kjo rrezikon që zona të caktuara të humbin vlerat për çka janë shpallur që janë, pra “zona të mbrojtura”, sepse nëse një zonë i humb vlerat si florën apo faunën dhe degradohet, atëherë ajo zonë hiqet si zonë e mbrojtur me ligj nga ligjet e Kosovës. Mosmarrja parasysh e padive që ka sjellë deri te pranimi në punë i personave të cilët kanë lëndë në gjykatë tregon se sa i brishtë është sistemi gjyqësor apo edhe zbatimi i ligjit në Kosovë. Pra përderisa persona të cilët degradojnë natyrën duhet të dënohen, kjo nuk ndodh në Kosovë, përkundrazi punësohen dhe në njëfar forme u jepet një shtytje që të fitojnë të ardhura ku pastaj mund të investojnë në pajisje të cilat mund t’i bëjnë dëm natyrës.
- **Gjuetia ilegale:** Kosova nuk ka një hulumtim të mirëfilltë sa i përket faunës, gjithashtu edhe mungesa e një zyrtari për faunë në Drejtorinë për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” bën që të mos dihet qartazi se sa është popullata e një lloji në një lokacion të caktuar, ose informacione kualitative rreth faunës në Parkun Kombëtar “Sharri”. Gjuetia ilegale në Parkun Kombëtar “Sharri” mund të çojë deri tek ulja e popullatës të një lloji të shtazëve në një habitat ku vihet në rrezik direkt zhdukja e llojit të shtazës. Pretekstet se gjuetia bëhet që të zvogëlohet numri i egërsirave është një argument i dobët. Ne si njerëz po hymë në territorin e huaj, në një hapësirë e cila është vendbanim i një lloji dhe kjo e bën njeriun apo thënë ndryshe “efektin antropogjen” evident dhe keqëbërës ndaj krijesave të tjera. Një e mirë e zonës së Parkut Kombëtar “Sharri” është vetëdijesimi i banorëve të cilët reagojnë menjëherë kur dëgjojnë të shtëna të armëve për gjueti, dhe lajmërojnë policinë. Gjuetia me qen (zagar) është një formë e gjuetisë shumë bizare sepse llojet e ndryshme të kafshëve largohen nga habitatet e tyre dhe hyjnë në habitat të një lloji tjetër, për shkak se qentë (zagaret) për gjueti janë të trajnuar të afrojnë pre të gjahtari i cili mund të jetë larg prej vendit ku gjendet preja. Kafshët e ndryshme largohen nga habitatet e tyre dhe hyjnë në habitate të tjera, që prish balancin ekologjik të Parkut Kombëtar “Sharri”.
- **Zjarret:** Habitatet si ai i Koretnikut i cili ishte djegur vite më parë e ka të pamundur të revitalizohet në mënyrë natyrale pasi që vlerat ushqyese të tokës në atë pjesë kanë humbur. Kurse nëse bëhet nga dora e njeriut vlerat siç kanë qenë nuk mund të kthehen perfundimisht por mund të zbutet dëmi. Zjarret e tjera të cilat janë bërë nga shkaqet si pikniqet apo nga shëtitjet e banorëve janë të vogla dhe lehtë të menaxhueshme por me mungesë të stafit, zjarret mund të eskalojnë në zjarre më të mëdha pasi që lokacionet e ndryshme janë të pambuluara nga rojtarët, sezona ku zjarret janë më të pranishme është sezona e verës ku natyra e Parkut Kombëtar “Sharri” është më e frekuentuar.



B. Aspekti ligjor

Korniza ligjore për mbrojtjen e Parkut Kombëtar “Sharri” dhe ndalimin e veprimeve ilegale si prerja e pyjeve, gjuetia ilegale dhe zjarret përbëhet nga një mori aktesh ligjore:

1. **Ligji Nr. 04/L – 087 për Parkun Kombëtar “Sharri”** përveç që ka të përcaktuara zonat e mbrojtura brenda parkut kombëtar në tre nivele, vlen të theksohet se mbrojtje e veçantë i kushtohet edhe Zonës së Ndikimit e cila përfshin hapësirën prej pesëdhjetë (50) metra nga kufiri i Parkut Kombëtar “Sharri” që shërben për parandalimin e ndikimeve të dëmshme në Parkun Kombëtar.⁶³
2. **Ligji Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës** përcakton se **dëmtim i natyrës** nënkupton dhe përfshin të gjitha aktivitetet e njeriut që i kanë ndryshuar proceset natyrore në masë sa që baraspesha natyrore është çrregulluar, ose janë shkatërruar vlerat e natyrës.⁶⁴ Sipas këtij ligji, **vlera e mbrojtur e natyrës** nga organi i përcaktuar me këtë Ligj dhe i regjistruar në Regjistrin e vlerave të mbrojtura të natyrës dhe ka të bëjë me zonat e mbrojtura përfshin: rezervati strikt i natyrës, **parku kombëtar, zona e veçantë, parku i natyrës**, monumenti i natyrës, peizazhi i mbrojtur dhe monument i arkitekturës së parkut, llojet e mbrojtura të bimëve, kërpudhave dhe shtazëve përfshirë ekzemplarët e ngordhur të llojeve të egra të mbrojtura në bazë të këtij Ligji dhe akteve ndërkombëtare, pjesëve dhe derivateve të tyre si dhe mineraleve, fosileve dhe shtresimeve të mbrojtura.⁶⁵

Bazuar në të dhënat e raportit dhe legjislacionin kombëtar, rezulton se zona e Parkut Kombëtar “Sharri” është **Zonë e Rëndësishme Ekologjike - ZRE** (territori i cili dukshëm kontribuon në ruajtjen e larmisë biologjike në Republikën e Kosovës)⁶⁶, si dhe **Zonë e Veçantë e Ruajtur - ZVR** (zonën e rëndësishme për Komunitetin e shpallur përmes masave ligjore, administrative dhe/ose aktit të kontratës kur masat e ruajtjes së domosdoshme janë zbatuar për mirëmbajtjen ose restaurimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimit natyror dhe/ose popullacionit të llojit për të cilin zona është shpallur)⁶⁷.

Rrjedhimisht, vlerat e mbrojtura të natyrës sipas këtij ligji janë: zona e mbrojtura, përfshirë këtu Parkun Kombëtar “Sharri”, ku të gjitha veprimtaritë lidhur me shfrytëzimin ekonomik e të mirave të natyrës⁶⁸ janë të ndaluara⁶⁹. Në këtë drejtim, ndalohet shfrytëzimi i të mirave të natyrës në mënyrën e cila shkakton **varfërimin e botës natyrore të bimëve, kërpudhave dhe shtazëve**⁷⁰ përveç punëve dhe veprimtarive me të cilat nuk rrezikohet natyra burimore⁷¹. Veprimtaritë shqetësuese ilegale që po ndodhin në këtë park janë të ndaluara me ligj dhe të njëjtat veprimtari (prerja ilegale e drunjëve/shpyllëzimi, gjuetia ilegale, zjarret) janë të dënuara sipas legjislacionit në fuqi.

63.Neni 3, para.1, pika 4 i Ligjit Nr. 04/L – 087 për Parkun Kombëtar;

64.Neni 7, para.1. pika 2 i Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

65.Neni 7, para.1, pika 57 i Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

66.Neni 7, para. 1, pika 60 i Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

67.Neni 7, pika 1.63 i Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

68.Neni 11, para. 4 i Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

69.Neni 8, para.1 i Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

70.Neni 123, para. 2, pika 3 i Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

71.Neni 11, para. 3 i Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;



► Për **ZJARRET**: Në rezervatin strikt, **parkun kombëtar, zonën e veçantë**, parkun e natyrës, peizazhin e mbrojtur, dhe në monumentin e arkitekturës së parkut **ndalohet ndezja e zjarrit** jashtë vendbanimeve dhe/ose vendeve që për këtë qëllim janë të shënuara dhe të caktuara.⁷²

► Për **GJUE TINË ILEGALE**: Nuk lejohet, pa arsye të justifikuar, që shtazët e egra të shqetësohen, të kapen, të lëndohen, të zvogëlohet numri i popullacionit të llojeve të tyre - vrasja, mënjanimi, shkatërrimi ose dëmtimi i vendbanimeve të tyre si dhe ndryshimi i kushteve jetësore të tyre në masën në të cilën lloji do të kërcënohet⁷³. Poashtu, ndalohet kapja ose vrasja e shtazëve të cilat i përkasin kategorisë të llojeve të egra të mbrojtura, përveç nëse gjuetia bëhet me qëllim të përpunimit, tregtisë dhe qarkullimit tjetër, atëherë nevojitet marrja e lejes nga Ministria me vendim, apo mund të kryhen me pëlqimin e pronarit ose bartësit të së drejtës në të mirat e natyrës.⁷⁴

► Për **DEGRADIMIN E PYJEVE PËRMES SHPYLLËZIMEVE**: Grumbullimi i bimëve, kërpudhave dhe pjesëve të tyre të cilat i përkasin kategorisë të llojeve të egra të mbrojtura është e ndaluar, përveç se nëse me qëllim të përpunimit, tregtisë dhe qarkullimit tjetër, atëherë nevojitet marrja e lejes nga Ministria.⁷⁵

3. **Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit** përcakton se në pjesën e mbrojtur të natyrës nuk mund të zhvillohen aktivitete të cilat e rrezikojnë ekuilibrin natyror, llojllojshmërinë biologjike dhe peizazhore, hidrografinë, gjeomorfologjinë, gjeologjinë, vlerat kulturore ose në çfarëdo mënyrë degradojnë cilësitë dhe veçoritë e vlerave të natyrës.⁷⁶

4. **Ligji Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës, Ligji Nr. 2004/29 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës**, si dhe **Ligji Nr. 03/L-153 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës** përcaktojnë atë që të gjithë personave të paaautorizuar u ndalohet mbajtja e mjeteve për prerjen e drunjve në pyjet publike. Asnjë person s'mund të presë dru në pyjet publike, përveç nëse personi ka licencën valide të lëshuar sipas këtyre ligjeve. Licenca për të prerë drunj në një pyll publik është valide vetëm nëse prerja është në pëlqim me planin menaxhues operacional valid që mbulon atë pyll. Për këtë, Agjencia Pyjore lëshon licenca dhe shënon drunj në një pyll publik sipas këtij neni.⁷⁷

Të gjitha veprimtaritë ilegale siç janë zjarrëvënia, gjuetia ilegale, si dhe degradimi i pyjeve përmes shpyllëzimit janë të dënuara me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe të njëjtat përfshihen në kategorinë veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore sipas **Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës**⁷⁸. Këto veprimtari përbëjnë vepra penale nga **Neni 338 - Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit, Neni 348 - Shkretërimi i pyjeve, Neni 349 - Vjedhja e pyllit, Neni 350 - Gjuetia e kundërligjshme**. Varësisht nga niveli i dëmit të shkaktuar, kryesit e këtyre veprave dënohen me dënim me burgim për kryerjen e veprave penale apo/dhe kundërvajtje (gjoba).

72. Neni 75 , para 1, pika 5 i Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

73. Neni 86, para. 2 i Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

74. Neni 90 i Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

75. Neni 90, para.1. i Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

76. Neni 12, para. 2 i Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;

77. Neni 20, para 1,2,3 & 4 i Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës;

78. Shih: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6A2D4377-6AE1-4530-909F-3FB2680CDIEC.pdf>

